



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:155702
Datë: 26.10.2023
Numri i dokumentit: 04834266

C.nr.4345/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses F.D, nga fshati "...", Komuna "...", të cilën me autorizim e përfaqëson: avokate L.D.P, me seli në Veternik, Rr: "Richard Holbrooke", p. n. Prishtinë, kundër të paditurës: "K.A", me seli në Lagjen "...", Graçanicë, me objekt kontesti: kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 26.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË SI E PALEJUAR padia e paditëses F.D, nën shenjë C.nr.4345/2023, e datës 18.07.2023, kundër të paditurës "K.A", me seli në Prishtinë, lidhur me kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja F.D nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me dt. 18.07.2023, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës "K.A", me seli në Prishtinë, përmes të cilës ka kërkuar që, e paditura ta kthejë paditësen në vendin e punës, sipas Kontratës së datës 01.08.2019, dhe që në emër të të ardhurave personale të pagave mujore t'ia paguajë paditëses shumën prej 301,62 euro, për çdo muaj, duke filluar nga data 01.06.2020 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës, e deri në ditën që do të kthehet në punë

Në padi ndër të tjera ka theksuar që, paditësja ka qenë në marrëdhënie të punës me të paditurën, duke u bazuar në Kontratën e punës të datës 01.08.2019, dhe njejta ka qenë në marrëdhënie pune deri me datë 01.07.2020, dhe nga kjo marrëdhënie e punës ka realizuar të ardhura në shumën prej 301,62 euro. Ka shtuar se e paditësja nuk posedon Kontratë të punës, pasi që asnjëherë nuk i është dhënë nga e paditura në posedim. Ka shtuar se me njoftimin verbal të datës 01.07.2020, nga menaxherja e të paditurës është njoftuar për vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe se pas këtij njoftimi, me shkresën e datës 08.07.2020, me anë të kërkesës së drejtuar tek e paditura, ka kërkuar që të i dorëzohet vendimi në formë të shkruar për ndërprerje të marrëdhënies së punës, mirëpo përfaqësuesit e të paditurës nuk kanë pranuar që ta nënshkruajnë dërgesë për pranimin e kërkesës së paditëses, dhe kërkesa është kthyer pas nga zyrtarët e postës.

Në padi pretendohet se gjatë kohës sa paditësja ka qenë në marrëdhënie të punës, e njëjta i ka përmbushur detyrat e saj të punës me përpikmëri dhe në mënyrë profesionale, dhe ndaj saj asnjë herë nuk është paraqitur ndonjë vërejtje verbale apo me shkrim, po ka qenë punëtore e dalluar. Në padi pretendohet se paditësja F.D, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë në inspektoratin e punës, kundër njoftimit verbal për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ka shtuar se inspektorati i punës, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses, dhe ka gjetur shkelje tek e paditura me rastin e largimit nga puna të paditëses F.D. Ky vendim, sipas paditëses është vërtetuar pjesërisht nga shkalla e dytë e inspektoratit, ku është anuluar vetëm shkelja sa i përket pushimit vjetor. Ka shtuar se e paditura për këto shkelje është gjobitur në shumën prej 2,000.00 euro nga inspektorati i punës.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht u lëshua në vlerësimin e faktit nëse janë përmbushur dy parakushte apo prezumime bazë: 1) që e punësuar - paditësja para se të kërkojë realizimin e të drejtës së pretenduar në rrugë gjyqësore, paraprakisht i ka shfrytëzuar procedurat interne pranë punëdhënësit dhe 2) nëse padia është dorëzuar brenda afateve të përcaktuara me ligj. Prezumimet në fjalë duhet përmbushur në mënyrë kumulative, në mënyrë që të ofrohet mbrojtje gjyqësore lidhur me të drejtat e pretenduara që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Në funksion të këtij vlerësimi, Gjykata iu referua Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i cili paraqet ligj të aplikueshëm në rastin konkret. Dispozita nga neni 78 e këtij ligji parasheh: "*1.I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2.Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. 3.Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.*". Në anën tjetër, dispozita nga neni 79 e po këtij ligji, parasheh që: "*Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente.*"

Në rastin konkret, nga thëniet e paditëses në padi si dhe provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, Gjykatës i rezulton se veprimi me të cilin pretendon se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës, është njoftimi verbal i datës 01.07.2020, pra e njëjta nuk ka pranuar asnjëherë vendim në formë të shkruar për largimin e saj nga puna. Paditësja, ka pretenduar që ka dërguar një kërkesë tek e paditura, me të cilën ka kërkuar që e paditura t'a njoftojë me vendim të shkruar për largimin e saj nga puna. Paditësja për këtë pretendim të saj, nuk ka paraqitur asnjë provë, megjithatë, e njëjta ka deklaruar – pohuar në padi se kërkesën për tu njoftuar me vendimin për largim nga puna në formë të shkruar e ka bërë me datë 08.07.2020. Në këtë kuptim, nga këto deklarime të palës së paditur, rezulton se paditësja ka qenë e njoftuar për largimin e saj nga puna që nga data 01.07.2020.

Bazuar në faktet e lartë cituara, paditësja, edhe pse pretendon se e njëjta ka shtjerrur mjetet e brendshme juridike tek punëdhënësi, pra ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të saj tek punëdhënësi, e njëjta nuk ka respektuar afatin ligjor prej tridhjetë ditësh për paraqitjen e padisë, në kuptim të

nenit 79 të Ligjit të Punës. Gjykata sjell në vëmendje se, paditësja, konform nenit 78 të Ligjit të Punës, ka pasur të drejtën për të kërkuar tek punëdhënësi mbrojtjen e të drejtave të saj, që derivojnë nga marrëdhënia e punës, dhe siç parashihet me nenin 79 të Ligjit të Punës, *(çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente)*, paditësja, pasi që nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga punëdhënësi, ka pasur mundësinë ligjore që brenda afatit vijues prej 30 ditësh të paraqesë padi në Gjykatë për mbrojtjen e të drejtave të saj nga marrëdhënia e punës, të cilat pretendon që i janë shkelur nga ana e punëdhënësit, këtu të paditurës. Siç rezulton nga faktet e lartëcituara, paditësja, ndonëse është njoftuar për largimin nga puna me datë 01.07.2020, e njëjta padinë në Gjykatë e ka paraqitur me datë 18.07.2023, pra pas kalimit të më shumë se tre viteve. Bazuar në këtë, Gjykata vlerëson se padia e paditëses është e pas afatshme, dhe në një rrethanë të tillë, paditëses nuk mund t'i ofrohet mbrojtje gjyqësore lidhur me pretendimet e saj të paraqitura me padi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditëses, se e njëjta ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të saj nga marrëdhënia e punës, dhe se inspektorati i punës, me vendimin nr. 01 Nr. 08-877/202B e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses, duke gjetur shkelje tek e paditura, me rastin e largimit nga puna të paditëses F.D, dhe se ky vendim pjesërisht është aprovuar edhe nga shkalla e dytë e inspektoratit të punës, me vendimin nr. 340/22, i datës 28.04.2022. Megjithatë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, fakti se paditësja i është drejtuar me ankesë inspektoratit të punës, nuk ka ndikim në trajtimin e padisë si të afatshme. Kjo për faktin se i punësuar i – këtu paditësja -, bazuar në nenin 82 të Ligjit të punës, ka të drejtë që të paraqes ankesë tek inspektorati i punës, por vetëm për çështje që bien brenda kompetencave të inspektoratit të punës. Bazuar në nenin 2 të Ligjit Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, kompetencat e këtij organi administrativ janë mbikqyrja e zbatimit të ligjit të punës dhe dispozitve të ligjeve të tjera që rregullojnë materie nga marrëdhënia e punës, dhe për shkeljet eventuale të gjetura, ky organ ka të drejtën shqiptimit të gjobave tek punëdhënësit. Së këndejmi, kontestet e kthimit të punëtorëve në vendin e punës, realizimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera që derivojnë nga marrëdhënia e punës, janë kompetencë e Gjykatës.

Bazuar në këto rrethana, vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se paditësja nuk e ka plotësuar parakushtin, që padinë në Gjykatë ta paraqesën brenda afatit ligjorë, parakusht ky i domosdoshëm që padia për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës të paraqitet në Gjykatë.

Si përfundim, Gjykata vlerësoj se, në këtë fazë të procedurës, padia duhet hedhur poshtë si e palejueshme, në kuptim të dispozitës së nenit 391 pika f) e LPK-së, e cila përcakton: *"Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj"*.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 450 të LPK-së, e cila përcakton që: “*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.*”

Mbi bazën e të lartë cekurave, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.4345/2023, dt. 26.10.2023

G j y q t a r i,
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.